



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit për shkeljen e rregullave ligjore në procesin zgjedhor të dorëzuar nga parashtrues i njohur, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 57-të, të mbajtur më 17.12.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura ndaj lëndës me numër 12-4030 nga viti 2021 me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, **NDËRPRITET**.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sepse në rastin në fjalë ndërsa me kërkesë të KSHPK-së ka vepruar organ tjetër kompetent dhe ka konstatuar se pretendimet t nuk u konfirmuan.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4030 nga viti 2021, e formuar sipas denoncimit me numër 12-4030 / 1 nga data 20.10.2021, e dorëzuar në KSHPK nga parashtruesi i njohur - "-----", me pretendime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor - Zgjedhjet lokale 2021. Konkretisht, në denoncim janë nxjerrë pretendimet kundër drejtorit të ISHP - -----, për shkak të lidhjes së kontratave të punës dhe punësimit të personave të caktuar në një periudhë të caktuar pune gjatë fushatës zgjedhore të filluar zyrtarisht, që sipas parashtruesit ishte në kundërshtim me Kodin zgjedhor .

Për verifikimin e pretendimeve dhe konstatimin e gjendjes faktike në rastin në fjalë, KSHPK-ja i ka paraqitur kërkesë Inspektoratit Shtetëror të Punës që të veprojë në kuadër të kompetencave ligjore dhe të kryejë një inspektim të jashtëzakonshëm në institucionin shëndetësor publik në fjalë lidhur me ligjshmërinë në procedurat e lidhjes së kontratave të punës dhe punësimit të personave të caktuar me kohë të caktuar që janë realizuar/zbatuar gjatë procesit zgjedhor 2021. Sipas kërkesës së KSHPK-së janë pranuar informacione me dokumentacion të bashkangjitur dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit të marrë është konstatuar:

Për rastin e denoncuar është bërë kontroll i jashtëzakonshëm dhe është përgatitur procesverbal në të cilin nga mbikëqyrja në vend të kryer nga punëdhënësi ISHP ----- është konstatuar se.

Gjithsej 312 persona janë punësuar nga punëdhënësi në bazë të punësimit në pajtim me ligjin, ndërsa 42 persona janë punësuar me kontratë pune. Kontratat e punës janë lidhur para datës 06.08.2021, pra para ditës së shpalljes së zgjedhjeve lokale, nga data 01.07.2021 deri më 31.12.2021 dhe nga 01.08.2021 deri më 31.12.2021.

- Për këtë veprim të punëdhënësit ka pasur pëlqimin e Ministrisë së Financave nr.----- nga data 10.03.2021, me të cilën punëdhënësit nëpërmjet Fondit të Shëndetësisë i jepet pëlqimi deri në fund të vitit, pra deri më 31.12.2021. punëson 61 persona me kontratë pune. Këta persona me kontratë pune janë angazhuar kryesisht për shkak të situatës epidemiologjike me KOVID-19 për shkak të mungesës së punonjësve shëndetësorë në periudhën kohore dhe të dislokuar apo të angazhuar në Repartin e Brendshëm dhe në Repartin e Mjekësisë së Brendshme dhe për nevojat e Spitalit Modular për KOVID 19.

- Në periudhën prej datës 06.08.2021 - kur janë shpallur zgjedhjet lokale 2021 - është konstatuar se ISHP në fjalë si punëdhënës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me procedurat për lidhjen e kontratave për punësim dhe punësimin e personave të caktuar në orar të caktuar të punës, d.m.th. për këtë periudhë nuk ka pasur punësime për asnjë bazë.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se lidhur me pretendimet e denoncuara, me kërkesë të KSHPK-së, ka vepruar organi tjetër kompetent dhe me inspektimin e jashtëzakonshëm të kryer, pretendimet nuk janë vërtetuar për çka KSHPK ka vendosur si në dispozitë të këtij Vendimi.

KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi

Punoi: J.C.
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së